

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSIG SHA

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në INSIG, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare dhe vlerësues” për periudhën nga data 01.01.2010 deri 31.12.2013, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 119 datë 18.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 245/12 datë 18.09.2014, dërguar Z. Edlira Dvorani, Administrator i Përgjithshëm, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm, u konstatua:

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm, nuk ka zbatuar dhe realizuar plotësisht rekomandimet e dërguara nga KLSH-së me shkresën nr. 847/6, datë 31.03.2007. Konkretisht nga 29 masa organizative, të rekomanduara me afatin kohor “menjëherë”, janë marrë në konsideratë dhe zbatuar plotësisht 21 masa, 5 masa nuk janë zbatuar dhe 3 masa janë zbatuar pjesërisht. Nga 2 masa zhdëmtimi të rekomanduara, është në proces zbatimi 1 masë, ndërsa 1 masë nuk është zbatuar, ndërsa nga 6 masa disiplinore të rekomanduara, janë zbatuar plotësisht 3 prej tyre, ndërsa 3 nuk janë zbatuar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm, të marrë masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat nga auditimi rezultuan të pazbatuara, si dhe të ndjekë me vëmendje të posaçme, ato të cilat janë në procese gjyqësore.

Vazhdimisht

2. Nga auditimi mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e programit ekonomiko-financiar, ndjekja dhe realizimi i treguesve ekonomiko-financiar në qendër dhe filiale, u konstatua:

-Për periudhën objekt auditimi, Insig Sh.a., nuk i ka dërguar për miratim Ministrit të Financës, në cilësinë e Aksionerit të vetëm të shoqërisë, buxhetin e miratuar nga organi drejtues i shoqërisë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kreu I “Asambleja e Përgjithshme”, në nenin 135 “Të drejtat dhe detyrimet”, pika 2, gërma a shprehet se: “Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë: a) përcaktimin e politikave tregtare”.

-Miratimi i buxhetit nga Këshilli Mbikëqyrës për Insig Sh.a. Shqipëri për vitin 2010, ka kaluar nëpërmjet dy ndryshimesh, me vendimin nr. 12, datë 08.10.2010 dhe vendimin nr. 17, datë 05.11.2010, të cilat kanë ndryshuar treguesit kryesor të buxhetit, të ardhurat, shpenzimet rrjedhimisht dhe fitimin e shoqërisë, ndryshime të cilat nuk janë miratuara tek Aksioneri, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kreu I “Asambleja e Përgjithshme”, neni 135 “Të drejtat dhe detyrimet”, pika 2, gërma a shprehet se:

“Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë: a) përcaktimin e politikave tregtare”.

-Insig Sh.a., nuk ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga Rregullorja nr. 1451, datë 16.12.2010 “Mbi hartimin e buxhetit dhe plan biznesit të Insig Sh.a.”, të Drejtorit të Përgjithshëm, që përcakton detyrimet dhe rregullat që duhet të zbatojë çdo strukturë për hartimin e buxhetit dhe plan biznesit të kësaj kompanie. Konkretisht Insig Sh.a. Shqipëri, nuk ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga pika 5, paragrafi i pestë i kësaj rregulloreje që përcakton se “Pas miratimit të buxhetit nga Këshilli Mbikëqyrës, pasqyra e buxhetit së bashku me vendimin përkatës, si dhe vendimet për ndryshimet e buxhetit, i paraqiten Aksionerit (Ministrit të Financave), për miratim. Miratimi i buxhetit nga Këshilli Mbikëqyrës për Insig Sh.a. Shqipëri për vitin 2012, ka kaluar nëpërmjet një sërë ndryshimesh. Ndryshimi i parë ka të bëjë me vendimin nr. 1, datë 30.01.2012, që përcakton shtimin e zërit “Shpenzime për Këshilltarin e Privatizimit të Insig Sh.a.”, në masën 130,000 Euro, sipas përcaktimit të fondit limit për Konsulentin Financiar. Ndryshimi i dytë në buxhetin e parashikuar për vitin 2012, është bërë me vendimin nr. 5, datë 13.06.2012 për treguesit, “shpenzime për qira” shtuar në vlerën 7,100 mijë lekë, “shpenzime për mirëmbajtje objekti dhe mjete kryesore të tjera” shtuar në vlerën 1,200 mijë lekë. Është pakësuar zëri “shpenzime për karburant” në vlerën 500 mijë lekë, “shpenzime për ekspert kontabël” në vlerën 1,300 mijë lekë, “shpenzime për roje civile” në vlerën 1,000 mijë lekë. Ndryshimi i tretë është miratuar me vendimin nr. 11, datë 3.10.2012, ku është miratuar shtimi në zërin “Shpenzime për sponsorizime” në vlerën 1,500 mijë lekë. Nga ndryshimet në buxhet, fitimi para tatimit, nga 181,039 mijë lekë i programuar në miratimin e parë, është programuar në vlerën 161,339 mijë lekë, ***pra është ulur fitimi i shoqërisë***, pa u marrë miratimi nga Aksioneri i vetëm, Ministri i Financave.

-Buxheti i vitit 2012 Insig Sh.a. Dega Kosovë, është miratuar pasi ka filluar viti ushtrimor dhe konkretisht me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 22.02.2012, kjo në kundërshtim me Rregulloren e brendshme nr. 1451, datë 16.12.2010 “Mbi hartimin e buxhetit dhe plan biznesit të Insig Sh.a.”, që përcakton detyrimet dhe rregullat që duhet të zbatojë çdo strukturë të Insig Sh.a., për hartimin e buxhetit dhe plan biznesit të kësaj kompanie. Miratimi i buxhetit nga Këshilli Mbikëqyrës për Insig Sh.a. Shqipëri për vitin 2013, është bërë në datën 17 Dhjetor 2012, brenda vitit ushtrimor, por nga treguesit ekonomike sipas tabelës së realizimit dhe programimit, ka diferenca që përthehen në mosrealizim dhe mos-programim të saktë të të ardhurave dhe shpenzimeve për këtë vit, gjithashtu një programim jo të saktë të hartimit të programeve, të zhvillimit ekonomiko-financiar të Insig Sh.a..

-Miratimi i buxhetit nga Këshilli Mbikëqyrës për Insig Sh.a. Dega Kosovë për vitin 2013, është bërë në datën 01 Janar 2013, jashtë vitit ushtrimor, në kundërshtim me Rregulloren e brendshme nr. 1451, datë 16.12.2010 “Mbi hartimin e buxhetit dhe plan biznesit të Insig Sh.a.”, që përcakton detyrimet dhe rregullat që duhet të zbatojë çdo strukturë të Insig Sh.a., për hartimin e buxhetit dhe plan biznesit të kësaj kompanie, pika 5, paragrafi 6.

-Treguesit ekonomiko-financiar për vitin 2013, paraqiten me diferenca të konsiderueshme, gjë që tregon për mos programim të saktë, kryesisht të shpenzimeve për rezervën teknike.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm, të miratojë programin ekonomiko-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, dhe nëse është parashikuar në statut dhe ligjet specifike, të miratohet edhe nga Aksioneri i vetëm, Ministri i Financave, si dhe të marrin masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm, të analizojnë çdo tremujor gjendjen ekonomiko-financiare të shoqërisë Insig Sh.a. Shqipëri dhe të Degës Kosovë. Në vartësi të rezultateve dhe problematikave të konstatuara, të nxirren vendimet dhe rekomandimet për zbatim, trajtuar më hollësisht në faqet 30-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Vazhdimisht

3. Nga auditimi mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, u konstatua:

-Për vitet 2010-2012, është dhënë shpërblim për punonjësit e Insig Sh.a. Shqipëri në vlerën 19,294,000 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve, neni 4.

-Në hartimin e projekt buxhetit, fondi për shpërblimin e punonjësve nuk është programuar, duke rritur shpenzimet për këtë zë në fund të vitit.

-Në 7 dosje të personelit nuk paraqitet inventari i dokumentacionit për punonjësin e punësuar. Pranë kësaj drejtorie nuk ka rregullore të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, ku të jenë përcaktuar kriteret e punësimit, sipas pozicionit të vendit punës.

-Nga ish-Drejtori i Përgjithshëm [REDAKTUAR] është lidhur me një punonjës kontratë pune 3/vjeçare, në kundërshtim me VKM nr. 478, datë 16.06.2010 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie”, pika 2.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm, të merren masa që shpërblimet për punonjësit në fund të vitit, të jepen sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, dhe vetëm pas daljes dhe miratimit të rezultatit ekonomiko-financiar të shoqërisë me fitim dhe të miratuar nga Aksioneri, Ministri i Financave.

Vazhdimisht

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm, të rishqyrtojë shpërblimin e dhënë për punonjësit e Insig Sh.a. Shqipëri për vitet 2010, 2011 dhe 2012 në vlerën 19,294,000 lekë (shpërblime të dhëna para daljes së rezultatit financiar vjetor), duke analizuar rezultatet financiare faktike sipas viteve në zbatim të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, neni 4, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës.

Brenda datës 30.11.2014

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm, të hartohet rregullorja e përcaktimit të kritereve të punësimit, sipas pozicionit të vendeve të punës dhe të merren masa për zbatimin korrekt në rekrutimin apo lëvizjen e punonjësve.

Brenda datës 31.12.2014

-Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Departamenti i Personelit të merren masat që çdo dosje e personelit, të jetë e pajisur me dokumentacionin e përcaktuar në rregullore, si dhe të ketë inventarin e dokumentacionit.

Vazhdimisht

4. Nga auditimi në shitjen e TPL dhe kartonit jeshil, u konstatua:

-Për shitje e TPL dhe të kartonit jeshil nën primin e rrezikut, nuk është zbatuar provigjoni teknik për primin e pa fituar, njëkohësisht nuk janë bërë ndryshime në planet e biznesit të viteve respektive, për të ardhurat nga të cilat do të mbulohen këto provigjone.

-Çmimet e pastra të përlllogaritura dhe të dorëzuara në AMF, nuk janë përlllogaritur sipas rregullores të AMF.

-Primet e dorëzuara në AMF, janë shumë më të ulëta, sesa primi real i përlllogaritur.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e Transportit", Rregulloren e AMF Nr. 110, datë 28.07.2011 "Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të transportit", sipas modelit të imponuar nga AMF.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm, aktuari i shoqërisë dhe Departamentet përkatëse, të zbatohen me korrektësi kërkesat ligjore dhe rregulloret e Autoritetit Mbikëqyrës për llogaritjen, miratimin dhe aplikimin e primeve të shitjes, dhe në asnjë rast të mos miratohen dhe aplikohen prime të shitjes nën primin e rrezikut, të miratuar nga autoritetet përkatëse. Çdo aplikim primi nën primin e rrezikut, përveç se duhet të mbahet në konsideratë në llogaritjen e provigjoneve teknike, duhet të njoftohet menjëherë Këshilli Mbikëqyrës i kompanisë dhe të nxirren përgjegjësitë përkatëse.

Vazhdimisht

5. Nga auditimi për procedurat e ndjekura për trajtimin e dëmeve motorike, u konstatua:

-Departamenti i Dëmeve Insig Sh.a., nuk ka udhëzim apo rregullore për trajtimin dhe pagesat e dëmeve të Kartonit Jeshil (dëme të kartonit jeshil që trajtohen nga korrespondentët dhe Byrotë trajtuese jashtë vendit), megjithëse kompania ka pagesa të konsiderueshme të dëmeve të Kartonit Jeshil.

-Nuk ka udhëzim për trajtimin dhe pagesat e dëmeve të Kartonit Jeshil, për dëmet që shkaktojnë mjetet e huaja në territorin Shqiptar (ku Insig është korrespondent i autorizuar për trajtimin dhe pagesat e dëmeve, por dhe kur këto dëme trajtohen dhe paguhen nga Insig në rol shërbyes me autorizim të BSHS, dhe që duhen rimbursuar).

-Udhëzimi nr. 1155, datë 02.11.2011 “Skema, asistencë në shërbimin e dëmeve, pasojë e përdorimit të Mjeteve Motorike”, vlerësojmë se duhet rishikuar në disa drejtime:

1. Në Udhëzim, nuk del e qartë procedura e hapjes së praktikës së dëmit, plotësimit të dokumentacionit, etj, nga Degët e Insig, në kushtet kur disa Dege kanë vlerësues dëmsh dhe disa Degë nuk kanë vlerësues dhe kapacitete për asistencën ndaj klientit.

2. Në Udhëzim nr. 1155, neni 6 pika d, theksohet se në raste të veçanta mund të hapen praktika dëmi pa paraqitjen e procesverbalit të Policisë Rrugore, por rregullorja 53 e AMF, nuk e përjashton në asnjë rast këtë dokument.

3. Nuk janë përcaktuar të qarta nivelet e kompetencës së vlerësimit, miratimit dhe pagesave të dëmeve. Të gjitha nivelet e dëmeve kanë të njëjtën procedurë vlerësimi nga një vlerësues dëmi, kjo duhet të ishte e diferencuar që për dëme me vlera të mëdha vlerësimi të bëhet me grup vlerësuesish.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Departamenti i Dëmeve të analizohet herë pas here, zbatimi i kërkesave ligjore dhe rregulloreve të trajtimit të Dëmeve, si dhe kriterëve të përcaktuara në Kushtet e Përgjithshme të Sigurimit në kontratat e Jo Jetës, për tu patur në konsideratë në të gjitha rastet e mosmarrëveshjeve ndërmjet siguruesit dhe të siguruarit, duke minimizuar proceset gjyqësore, pasi nga vonesa në trajtimin dhe vlerësimin e dëmit, krijohen efekte financiare negative në dëm të shoqërisë nga pagesa e kamat-vonesave dhe shpenzimeve gjyqësore e përmbartimore. Të miratohet rregullore e veçantë për ndjekjen dhe zgjidhjen e ankesave me marrëveshje gjyqësore dhe jashtë gjyqësore për dëmet.

Vazhdimisht, rregullorja të hartohet brenda datës 31.12.2014

-Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Departamenti i Dëmeve, të merren masa për të ndryshuar nenin 6, pika d, e Udhëzimit nr. 1155 datë 02.11.2011, duke hequr paragrafët e përjashtimit të procesverbalit të policisë rrugore për raste të veçanta, bazuar në rregulloren e AMF, miratuar me vendim Bordin nr. 53, datë 26.06.2009.

Brenda datës 31.12.2014

-Specialisti i dëmeve në hartimin e relacionit, duhet detyrimisht, që për rrethanat e ndodhjes së aksidentit, ti përshkruajë ato me kujdes, sipas ekspertizës në vendin e ngjarjes dhe deklarimeve të palëve të përfshira në aksident, sipas kërkesës së klientit për hapjen e praktikës së dëmit dhe ekspertizën e kryer në vendin e ngjarjes.

Vazhdimisht

-Departamenti i Dëmeve të dërgojë më shumë praktika për investigim, jo vetëm për vërtetësinë e rastit të sigurimit, por edhe për raste me problematika të tjera. Për raste, të cilat janë të dyshimtë nëse përbën apo jo raste sigurimi, departamenti ose Drejtori i Përgjithshëm, duhet të autorizojnë kryerjen e investigimit të rastit, dhe pastaj të vendosë nëse është apo jo i dëmshpërblueshëm. Kjo procedurë të zbatohet edhe për praktikatat e dëmeve që miratohen me komision.

Vazhdimisht

-Për të gjitha rastet ku Departamenti i Dëmeve autorizon kryerjen riparimit të mjeteve pranë serviseve të autorizuar, ti pajisë ato me autorizimin përkatës (sipas nenit 35, pika a, Udhëzimit nr. 1155 datë 20.11.2011).

Vazhdimisht

-Departamenti i dëmeve duhet të marrë masat që në koordinimin e punës, të mos kalojë afatet e trajtimit dhe pagesave të dëmeve të parashikuara në Udhëzimin nr. 1155, datë 02.11.2011, Kreu IV, neni 19 “Procedura e Trajtimit të Praktikave dhe rregulloren e AMF”. Për çdo rast të mos zbatimit të afateve, dhe kur kompania penalizohet me kamat-vonesa, etj, Drejtori i Përgjithshëm të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse.

Vazhdimisht

-Vlerësuesi i dëmeve duhet të aplikojë pjesën e zbritshme rast pas rasti, sipas % së vendosur në policën e sigurimit. Për rastet kur konstaton aplikime gabim të pjesës zbritshme në kontratë, duhet të njoftojë dhe marrë miratim paraprak nga Drejtori i Departamentit të Shitjes, lidhur me % që duhet aplikuar, dhe jo të vendosë vetë Departamenti i Dëmeve.

Vazhdimisht

-Departamenti i Dëmeve, me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm, duhet të bëjë azhurnimin e manualit nr. 2, si dhe freskimin e katalogëve, ku të përfshihet viti, dhe lloji i katalogut të fundit mbi të cilin duhet të punohet, dhe të ndjek specialistët për zbatimin e tyre.

Brenda datës 31.12.2014

-Në vlerësimin e dëmeve, të përdoret katalogu i periudhës përkatëse dhe i unifikuar për të gjithë vlerësuesit e dëmeve. Në vlerësimin e dëmeve, veçanërisht përdorimi i niveleve maksimale të katalogut, duhet të argumentohet në çdo akt vlerësimi me relacion përkatës të dëmit, si dhe kur gjykohet nga Drejtori i Departamentit, të bëhen edhe vlerësime me vlerësues alternativ.

Vazhdimisht

6. Nga auditimi me zgjedhje mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla, u konstatua:

-Insig Sh.a. Dega Kosovë, për periudhën 01.09.2012-30.06.2013, ka kryer shpenzime “Reklamë, Marketing dhe Publicitet”, **në vlerën 791,500 Euro**. Këto shpenzime janë kontabilizuar në llogarinë “6083/3-Shpenzime të tjera të marrjes në sigurim”, dhe në jo në llogarinë “624-Shpenzime Reklamë, Publicitet dhe Marketing”. Për këto nuk është ndjekur procedura ligjore për përzgjedhjen e operatorit për kryerjen e këtyre shërbimeve, nuk është zbatuar Ligji i Shtetit të Republikës së Kosovës nr. 03/L-114, datë 18.12.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit (gjatë auditimit dhe me observacione), nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, pasi një pjesë e dokumentacionit justifikues bazë është me mangësi, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, VKM nr. 1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave radiotelevizive ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës Shtetërore”, Udhëzimin nr. 1247, datë 04.12.2006, të Drejtorit të Përgjithshëm [REDAKTUAR] Udhëzimin nr. 2181, datë

14.07.2010, të Drejtorit të Përgjithshëm [REDAKTUAR] Udhëzimin Administrativ nr. 15/2010, datë 19.11.2010 të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave “Për zbatimin e Ligjit nr. 03/L-222 mbi Administratën tatimore dhe procedurat”, Ligjin nr. 03/L-114, datë 18.12.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe kontratën e nënshkruar midis palëve.

-Shpenzimet e kryera me procedurën e blerjeve me vlera të vogla, nuk janë të pasqyruara në regjistrin e realizimit të prokurimit të realizuara me vlera të vogla, në kundërshtim me pikën 2/a të Kreut VI “Zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozime, prokurim me vlerë të vogël, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit”, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, pikën 2 dhe 4 të Udhëzimit nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

-Në dy raste me vlerë 1,117 mijë lekë, është tejkaluar kufiri i lejuar për procedurën e prokurimit me vlera të vogla, në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, pikën 4.

-Mandat arkëtimet e pagesat janë pa numër serie. Ato plotësohen me numër rendor dhe datë.

-Në 5 raste me vlerë 8,246 mijë lekë, fondet për reklamë dhe sponsorizimi, janë kryer në kundërshtim me VKM nr. 1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore dhe Ligjin nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për Sponsorizimet”, me ndryshimet.

-Nga ish-Drejtori Përgjithshëm [REDAKTUAR] është lidhur kontratë me datën 21.12.2012 me servisin [REDAKTUAR] për riparimin e mjeteve të aksidentuara.

Për periudhën nga lidhja e kontratës me datë 21.12.2012 deri 31.12.2013, faturat e paraqitur nga ky servis janë fatura të thjeshta tatimore, ndërkohë që tejkalon kufirin për vlerën e shtuar, në kundërshtim me VKM nr. 1058, datë 21.10.2009 “Për përcaktimin e kufirit minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të shqyrtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit, **vlera 791,500 euro**, e pasqyruar si shpenzime “Reklamë, Marketing dhe Publicitet”, të kryera në Insig Sh.a. Dega Kosovë, duke respektuar kërkesën e materialitetit dhe të paraqitjes së sinqertë dhe të vërtet të destinacionit të kryerjes së këtij shpenzimi, duke respektuar plotësisht ligjet në të dy vendet tona, në funksion të aktivitetit të këtyre degëve, pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit (gjatë auditimit dhe me observacione), nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, pasi një pjesë e dokumentacioni justifikues bazë është me mangësi.

Brenda datës 30.10.2014

-Nga Drejtori i Përgjithshëm, të merren masa për të hartuar regjistrin e realizimit të prokurimit me vlera të vogla, duke raportuar çdo 4-mujor, si dhe të shërbejë si bazë për programimin e tyre në vitin pasardhës.

Vazhdimisht

-Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit, të merren masa, që për veprimet që kryhen me lekë në dorë nëpërmjet arkës, mandat arkëtimi dhe mandat pagesa, të jenë blloqe me numër serie.

Vazhdimisht

-Nga Drejtori i Përgjithshëm të merren masa, që të inventarizohet dhe arkivohet dokumentacioni në dosjet e shpenzimeve për reklamë publicitet dhe sponsorizime.

Menjëherë

-Nga Drejtori i Përgjithshëm, të mos rinovohet kontrata për riparimin e automjeteve me subjektin privat "██████" me numër regjistri 220 dhe NIPT K91406013C në Komunën ██████ si dhe për periudhën e mbetur të realizimit të kontratës, ti kërkohej paraqitja e faturave tatimore me TVSH, trajtuar më hollësisht në faqet 63-84, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në përfundim të kontratës

7. Nga auditimi në mbajtjen e evidencës kontabile në qendër dhe filiale, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit, u konstatua:

-Gjendja debitoare dhe kreditore është në shifra shqetësuese për Insig Sh.a. E megjithatë, nga organet drejtuese të saj, nuk është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre. Konkretisht gjendja debitoare është në vlerën 522,613,619.12 lekë për vitin 2010, në vlerën 508,033,599.77 lekë për vitin 2011, në vlerën 561,169,897.39 lekë për vitin 2012 dhe në vlerën 575,236,792.41 lekë për vitin 2013. Ndërsa gjendja kreditore është në vlerën 536,289,736.42 lekë për vitin 2010, në vlerën 534,026,450.24 lekë për vitin 2011, në vlerën 527,513,978.25 lekë për vitin 2012 dhe në vlerën 523,465,105.62 lekë për vitin 2013. Duke ju referuar të ardhurave dhe shpenzimeve, gjendja debitoare zë respektivisht 63.10% për vitin 2010, 71.30% për vitin 2011, 73.94% për vitin 2012 dhe 86.36% për vitin 2013, të të ardhurave, ndërsa gjendja kreditore zë 96.14% për vitin 2010, 109.51% për vitin 2011, 95.11% për vitin 2012 dhe 95.77% për vitin 2013, të shpenzimeve.

-Insig Sh.a., nuk ka paraqitur pasqyra financiare të konsoliduara në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare brenda datës 31 Maj, në kundërshtim me Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", i ndryshuar, neni 72, pika 3, e cila në mënyrë eksplicite përcakton se: "...Nëse shoqëria e sigurimit përgatit llogari të konsoliduara ose zotëron pjesëmarrje në shoqëri të tjera, ky raport paraqitet në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, jo më vonë se data 31 maj e vitit pasardhës".

-Insig Sh.a, nuk ka hartuar pasqyra financiare në përputhje me SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare", SNK 16 "Aktivet afatgjata Materiale", SNK 37 "Provizionet, Pasivet dhe Aktivët e Kushtëzuara", SNK 21 "Efekti e ndryshimit në kurset e këmbimit". Nga kjo mosparaqitje e duhur, Insig Sh.a. Dega Kosovë, nuk ka paraqitur në pasqyrat financiare vjetore, provizione për

humbjet gjyqësore në vlerën 9,915,116.711 euro për vitin 2010, në vlerën 9,649,682.46 euro për vitin 2011, në vlerën 13,538,693.38 euro për vitin 2012 dhe në vlerën 4,445,954.00 euro për vitin 2013.

-Insig Sh.a. Dega Kosovë, ka paraqitur në pasqyrat e saj financiare, në zërin e “Mjete Transporti”, për vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013, pesë automjete transporti të cilat sipas lejeve të qarkullimit përkatëse, rezulton se nuk janë në pronësi të saj, por të Insig Sh.a. Shqipëri (kompanisë mëmë), duke shtuar në mënyrë fiktive, zërin e bilancit “2151 Mjete Transporti”, për vitet ushtrimore 2010, 2011, 2012 dhe 2013, përkatësisht në vlerat 12,974.86 Euro, 15,714.33 Euro, 19,138.91 Euro dhe 23,419.89 Euro, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 9, SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” dhe SNK 16 “Aktivet afatgjata Materiale”.

-Insig Sh.a., ka paraqitur në pasqyrat financiare, në zërin e “Mjete Transporti”, për vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013, dy automjete të humbura me vlerë kontabile 1,084,000.19 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7.

-Insig Sh.a. Dega Kosovë, ka në përdorim të saj automjete për të cilat nuk është kryer regjistrimi, nuk janë paguar taksat, nuk është kryer kolaudimi dhe nuk ekziston siguracion i detyrueshëm (TPL) i prerë, në kundërshtim me Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, neni 4 dhe Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 92.

-Insig Sh.a. Dega Kosovë, nuk ka kryer inventarizime dhe pse kanë dalë urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm për kryerjen e tyre, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 6 dhe Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7.

-Insig Sh.a. Shqipëri dhe Insig Sh.a. Dega Kosovë, nuk kanë kryer procedura për nxjerrjen jashtë përdorimi të inventarit, me gjithë rekomandimet e komisioneve të inventarizimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, neni 6, pika e dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 2, 5, 96 dhe 100 të tij.

-Insig Sh.a. në të gjithë urdhrat për kryerjen e inventarizimeve për vitet 2011, 2012 dhe 2013, përmend si bazë ligjore Ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare”. Kjo bazë ligjore është e gabuar, pasi ky ligj është shfuqizuar më datë 01.01.2011 me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 34.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Mbikëqyrës, Drejtori i Përgjithshëm, Departamenti i Financë-Kontabilitetit dhe Dega Insig Kosovë, të analizojnë gjendjen debitore dhe kreditore më datë 31.12.2013, si dhe të marrë

masat e nevojshme për reduktimin e tyre, trajtuar më hollësisht në faqet 84-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.11.2014

-Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit, të merren masa për hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), trajtuar më hollësisht në faqet 84-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

-Nga Këshilli Mbikëqyrës, Drejtori i Përgjithshëm, Departamenti i Financë-Kontabilitetit dhe Dega INSIG Kosovë, të merren masa për inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të inventarit ekonomik, pajisjeve, pjesëve këmbimit, aktive afatgjata, (për vlerat materiale të evidentuara jashtë përdorimit nga komisionet përkatëse deri më datë 31.12.2013, por që akoma nuk janë përmbyllur procedurat), si dhe të hartohet dokumentacionin i plotë, ku të pasqyrohen shkaqet e nxjerrjes jashtë përdorimit, karakteristika dhe gjendja e vlerave materiale, koha e përdorimit, shkaktarët e prishjeve të dëmtimeve (nëse ka), në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 6, pika 1, germa e, dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 82-102, trajtuar më hollësisht në faqet 84-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm, të merret në shqyrtim gjendja e aseteve të shoqërisë, veçanërisht asetet (zyra, garazhe, etj) që aktualisht nuk janë në përdorim ose janë të pa hipotekuara, trajtuar më hollësisht në faqet 84-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

8. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, u konstatua:

-INSIG SH.A., nuk disponon udhëzim rregullativ të shkruar lidhur me zbatimin e ligjit për Menaxhimin Financiar, në lidhje me përcaktimin e strukturave menaxheriale, përcaktimin e nëpunësit autorizues, nëpunësit zbatues dhe përgjegjësitë përkatëse si dhe linjat e raportimit.

-Menaxhimi i zërave të shpenzimeve realizohet me rregullore të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës që në vitin 1999, dhe për Degën Kosovë me udhëzim të Drejtorit të Përgjithshëm. Kjo rregullore, duhet të ishte përmirësuar në funksion të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, dhe ndryshimeve ligjore dhe nënligjore në funksion të këtij ligji.

-Menaxhimi i vlerave materiale, inventarizimit dhe nxjerrjet jashtë përdorimit rregullohet, mbështetur në udhëzimin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 3527, datë 13.11.2007, kjo rregullore duhet të ishte ndryshuar në zbatim të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve”, të Ministrit të Financave.

-Ka mangësi në bazën rregullative të kryerjes dhe kontrollit të pagesave, manualeve të kontabilitetit, kjo në funksion të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, pasi udhëzimi i pagesave është i vitit 2004, manuali i kontabilitetit dhe lista e llogarive të miratuara në vitin 2004, etj.

-Nuk është parashikuar në akte të veçanta, rregullimi i menaxhimit operacional për urdhrat e kundërshtuar dhe rregullat, për delegimin e detyrave si dy operacione kryesore, në menaxhimin financiar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm të merren masa, për të hartuar udhëzuesin rregullativ, të shkruar lidhur me zbatimin e ligjit për Menaxhimin Financiar, në lidhje me përcaktimin e strukturave menaxheriale, përcaktimin e nëpunësit autorizues, nëpunësit zbatues dhe përgjegjësitë përkatëse, si dhe linjat e raportimit, trajtuar më hollësisht në faqet 118-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

-Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Dega Kosovë në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, të merren masa për hartimin dhe miratimin në Këshillin Mbikëqyrës të rregulloreve të brendshme të menaxhimit si:-Rregullore e menaxhimit dhe kontrollit të zërave të shpenzimeve, -Rregullore për disiplinimin e pagesave dhe -Rregullore për menaxhimin e vlerave monetare e materiale të kompanisë, duke shfuqizuar ose korrigjuar udhëzimet dhe rregulloret në fuqi, të nxjerra para hyrjes në fuqi të Ligjit “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, trajtuar më hollësisht në faqet 118-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

9. Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin e aktiveve financiare (depozita, bono thesari etj), u konstatua:

-Në vitin 2013, Insig Sh.a. mjetet financiare në vlerën 518,498,560.96 lekë, pasi janë maturuar, nuk i ka riinvestuar në bono thesari. Nga këto, 278,000,000 lekë janë investuar në depozita afatshkurtra (1-6 mujore) bankare në bankat e nivelit të dytë, ndërsa pjesa tjetër në vlerën 240,498,560.96 lekë, deri më datë 31.12.2013, nuk janë riinvestuar, por janë transferuar në llogaritë rrjedhëse. Nga këto veprime, Insig Sh.a. i janë krijuar të ardhura të munguara në vlerën 722,279.04 lekë. Veprime në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 12.02.2013 “Rregullore mbi politikën e investimeve në Insig Sh.a.”, pika 4.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit, të merren masa që para çeljes së depozitave të reja bankare, të kryhet një analizë e mirëfilltë e flukseve monetare për të parë mundësinë e përfitimit të interesave për këto mjete monetare dhe të nxirren përgjegjësit, trajtuar më hollësisht në faqet 123-126, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

10. Nga auditimi i pasqyrave financiare, të Degës Insig Kosovë dhe Shoqërisë Insig Sh.a., të dokumentacionit të vënë në dispozicion, të të dhënave të sektorit IT, departamentit të financës,

departamenti juridik, departamenti të dëmeve, aktuares, raporteve të auditimit të auditorëve të pavarur, që kanë çertifikuar pasqyrat financiare, korrespondenca me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Ministrinë e Financave etj, u konstatua se pasqyrat financiare të degës së Kosovës, nuk paraqesin gjendjen në fakt të shoqërisë më datë 31.12, për vitet 2010,2011,2012 dhe 2013.

Personat e ngarkuar me përgjegjësi sipas funksioneve respektive, jo vetëm kanë patur dijeni dhe nuk kanë paraqitur saktësisht situatën financiare të Degës Insig Kosovë, por me veprimet dhe mosveprimet e tyre, kanë ndikuar në rezultatin financiar të shoqërisë Insig Sh.a.. Konkretisht Dega Kosovë për vitet 2010, 2011, është paraqitur në pasqyrat financiare me fitim, po ashtu dhe bilanci i konsoliduar i shoqërisë Insig SH.A, është paraqitur me fitim, duke ndarë dhe dividendë, në një kohë që Dega Kosovë ka dal me humbje, dhe si rezultat i kësaj humbje dhe bilanci i konsoliduar i shoqërisë Insig SH.A, nuk del me fitim por del me humbje. Konkretisht bilanci i konsoliduar i shoqërisë Insig SH.A, në vitin 2010 është pasqyruar me fitim në vlerën 288,047,922 lekë dhe me vendim të Ministrit të Financave nr. 13736/1 datë 13.07.2011, është ndarë dividend në vlerën 288,047,922 lekë,

Në vitin 2011, bilanci i konsoliduar i shoqërisë Insig SH.A, është pasqyruar me fitim në vlerën 215,904,670 lekë, dhe me vendim të Ministrit të financave nr. 14499/2 datë 25.09.2012, vlera 13,757,490 lekë ka kaluar në investime dhe vlera 202,147,180 lekë është ndarë dividend.

Situata e mësipërme ka ardhur pasi:

Strukturat drejtuese dhe stafi teknik, nuk ka kërkuar zgjidhjen e shpejtë dhe korrekte të situatës financiare, por kanë manipuluar rezervat teknike të dëmeve, duke pasqyruar në organet mbikëqyrëse, si Banka Qendrore Kosovare dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të dhëna të tjera rezervash, nga ato reale. Kjo është realizuar:

1. Duke mos pasqyruar në pasqyrat financiare, rezervat e dëmeve që janë në proces gjyqësor dhe ato që janë proces përmbarrimor, në vlerën 9,915,116 euro për vitin 2010, në vlerën 9,649,682 euro për vitin 2011, në vlerën 13,538,693 euro për vitin 2012 dhe në vlerën 4,445,954 euro për vitin 2013. Këto diferenca kanë ardhur për arsye se, dëmet janë të kontabilizuar sipas vlerës së departamentit të dëmeve dhe jo të rivlerësuara sipas vendimeve të gjykatave.

2. Rezervat për dëmet që nuk janë në proces gjyqësor të pasqyruara në pasqyrat financiare, nuk janë paraqitur saktë, pasi në periudha të ndryshme, janë bërë rivlerësime, duke ulur vlerat e rezervimit, çka nënkupton që ka ndërhyrje në sistem.

3. Duke mos i regjistruar fare një pjesë të dëmeve në data-bazin e departamentit të dëmeve, edhe pse disponoheshin dosjet përkatëse nga ky departament në vlerën 1,934,904 euro në vitin 2012.

4. Nuk janë vlerësuar raportet e Audituesve të Jashtëm të Pavarur, të cilët në raportet e viteve ushtrimore 2010 (■■■■), 2011 (■■■■) dhe 2012 ■■■■, kanë dhënë opinion të kualifikuar mbi mënyrën e llogaritjes së rezervave teknike për dëmet, pasi llogaritja e saktë e tyre, do kishte ndikim material

në pasqyrat financiare të viteve respektive.

Mosparaqitja e saktë e pasqyrave financiare ka krijuar:

-Nxjerrjen me fitim të Shoqërisë

-Dhënie shpërblim për punonjësit e administratës për Shqipërinë në vlerën 19,294,000 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë Insig Sh.a., të analizojë gjendjen financiare të Insig Sh.a. Dega Kosovë, duke kryer paraprakisht rivlerësimin e rezervave teknike

për dëmet në proces gjyqësor dhe paraqitjen e tyre në kontabilitet konform dispozitave ligjore, si dhe të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e situatës së krijuar. Lidhur me gjendjen financiare të Degës Kosovë, nivelin e rezervave teknike dhe të mjaftueshmërisë së kapitalit, të merren në konsideratë dhe të zbatohen edhe rekomandimet e Bankës Qendrore të Kosovës dhe të audituesit të pavarur (ekspertit kontabël) të pasqyrave financiare. Pas rivlerësimit të situatës të merren vendimet përkatëse nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Aksioneri i vetëm, sipas kërkesave ligjore, trajtuar më hollësisht në faqet 126-134, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

11. Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien me qira të aktiveve afatgjata materiale, u konstatua:

-Insig Sh.a., ka paguar shpenzimet e ambienteve të marra me qira për agjentët dhe punonjësit e Insig Sh.a, në kundërshtim me kushtet e kontratës tip me agjentin, miratuar me Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 80, datë 12.10.2006 “Për miratimin e kontratës së agjentit”, neni 6, pika 14 dhe Vendimin nr. 18, datë 27.02.2012 “Për miratimin e kontratës së agjentit për personin fizik”, neni 6, pika 14, si dhe kontratave individuale. Nga këto veprime, Insig Sh.a., i është shkaktuar një efekt financiar negativ në vlerën 25,854,866 lekë dhe 12,000 Euro.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të shqyrtohet nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm, vlera 25,854,866 lekë dhe 12,000 euro, që përfaqëson pagesat e kryera për ambientet e marra me qira, për shitjen e policave nga agjentët dhe punonjësit e Insig Sh.a. Nëse qiratë konsiderohen jo të mbështetura ligjërisht dhe jo efektive të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës. Për periudhën në vazhdim të bëhen saktësimet përkatëse në vendimet e Këshillit Mbikëqyrës, rregulloreve dhe kontratën e agjentit, lidhur me marrjen me qira të ambienteve, përdorimin e tyre, duke i lidhur gjithmonë me efektivitetin e përdorimit të zyrave përkatëse, trajtuar më hollësisht në faqet 122-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Në mënyrë të detajuar aneksi nr. 1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit,

Brenda datës 30.10.2014

12. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, si dhe menaxhimi me efektivitet i shoqërisë në tregun e sigurimeve, u konstatua:

-Në vitin 2013, nga ish-drejtori i përgjithshëm [REDAKTUAR] janë dhënë 49 urdhra për ndryshime tarifash, me një mesatare ndryshimi të çmimeve, çdo 7 ditë. Ndryshimi i shpeshtë i këtyre tarifave, në disa raste kanë qenë jo efikase, pasi kanë krijuar çrregullime në sistem, ku në disa raste koha e ndryshimit të vlerës së primit, nuk është e njëjtë për të gjitha degët, duke krijuar diferenca në dëm të shoqërisë, për rreth 2,6 milion lekë.

-Nga ish-Drejtori i Përgjithshëm [REDAKTUAR] është dhënë urdhri nr. 6, datë 07.02.2012, ku janë miratuar tarifa për primit, minimale nën vlerën e përcaktuar nga AMF (5,760 lekë primi), çmim nën vlerën e rrezikut. Një urdhër i tillë, me çmim minimal e maksimal, lë mundësi abuzimi për agjentët, çka ngarkon me përgjegjësi ish-drejtorin e Përgjithshëm [REDAKTUAR] dhe ish-aktuarin [REDAKTUAR] të cilët kanë miratuar këto çmime për primit.

-Në 4 raste, paraqiten pagesa të ndryshme të komisioneve për agjentët për të njëjtën periudhë, sipas miratimit të urdhrave të dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm. Vlera prej 360,579 lekë, përbën diferencën e komisionit të miratuar vetëm për disa agjentë krahasuar me urdhrat e dhëna për tarifën e komisionit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të automatizohen komisionet e agjentëve në sistemin financiar, lidhur me sistemin e shitjeve, si dhe të ndërtohen raporte kontrolli në mënyrë që të minimizohen gabimet në llogaritjet e komisioneve të agjentëve dhe të drejtat dhe detyrimet që ata kanë ndaj Insig Sh.a.,

Brenda datës 31.12.2014

-Komisionet e agjentëve të përfshihen në programin e kontabilitetit (niveli i miratuar i komisioneve nga Autoritet drejtuese), duke e integruar në mënyrë automatike me programin e shitjeve (primet nga shitja sipas kontratave), si dhe të ndërtohen raporte llogaritje dhe kontrolli në mënyrë që të minimizohen gabimet në llogaritjet e komisioneve të agjentëve, edhe të drejtat dhe detyrimet që ata kanë ndaj Insig Sh.a.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Nga auditimi u konstatua se: Me urdhrin nr. 68, datë 27.03.2013, ish-drejtori i përgjithshëm [] për 7 punonjës, ka miratuar dhënie shpërblimi për punë të mirë, në zbatim të kompetencave të Drejtorit të Përgjithshëm sipas nenit 13 të Statutit. Ka përfituar shpërblim ish-drejtorja e Departamentit Financë/Kontabilitet [] e cila ka filluar punë në datën 28.01.2013, pra për dy muaj punë, ka përfituar 1 pagë shpërblim dhe [] ka përfituar 2 paga mujore shpërblim, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve, neni 4 dhe 6.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit, të merren masa për arkëtimin e vlerës **167,534 lekë**, si përfitim i pa drejtë në shpërblime, nga [] në vlerën 74,560 lekë, [] në vlerën 55,174 lekë dhe [] në vlerën 37,800 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, neni 4,

Brenda datës 31.11.2014

2. Nga auditimi u konstatua se: Në 15 raste për vitin 2012 dhe 49 raste për vitin 2013, nga drejtori ekzekutiv [] janë bërë ndryshime të shpeshta të tarifave, tarifa të cilat nuk janë zbatuar njëlloj nga të gjitha pikat e shitjes, pra nuk është përdorur e njëjta tarifë për çmimin e policës, sipas urdhrat përkatës, duke krijuar një dëm ekonomik për llogari të Insig sh.a në vlerën 2,547,072 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **2,547,072 lekë**, dëm i krijuar nga agjentët, si pasojë e mos zbatimit të urdhrave të drejtorit ekzekutiv për tarifën e sigurimi (TPL).

Brenda datës 31.12.2014

3. Nga auditimi u konstatua se: Në degët Fier, Berat, Sarandë, Gjirokastrë, Lushnjë, Kavajë, Durrës, Pogradec, Shkodër, Dibër, Korçë, Vlorë dhe Tiranë në 1046 raste, për vlerën 10,223,382 lekë, është kryer sigurimi i detyrueshëm i mbajtësve të mjeteve motorike, i ndryshëm me tipin e mjeteve regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve dhe Transportit Rrugor, dhe si rezultat i këtyre veprimeve, shoqërisë Insig Sh.a., i është krijuar një dëm ekonomik në vlerën 10,223,382 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 47 neni 54, dhe Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve rrugore”, neni 4, pika 1.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **10,223,382 lekë**, dëm i krijuar nga agjentët, pasi sigurimi i detyrueshëm i mbajtësve të mjeteve motorike, është kryer i ndryshëm me tipin e mjeteve të regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve dhe Transportit Rrugor, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 47 neni 54, dhe Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve rrugore”, neni 4, pika 1.

Brenda datës 31.12.2014

4. Nga auditimi u konstatua se: Në 4 raste, paraqiten pagesa të ndryshme të komisioneve për agjentët për të njëjtën periudhë, sipas miratimit të urdhrave të dhënë nga Drejtorit i Përgjithshëm. Vlera prej 360,579 lekë, përbën diferencën e komisionit të miratuar vetëm për disa agjentë krahasuar me urdhrat e dhëna për tarifën e komisionit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **360,579 lekë**, përfitim tepër komisionesh nga agjentët.

Brenda datës 30.10.2014

5. Nga auditimi u konstatua se: Në 3 raste me vlerë 1,049.29 euro dhe 8,800 lekë, janë paguar shpenzime nëpërmjet arkës, pa dokumentacionin justifikues (vërtetues), në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 6, i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 889.29 euro, nga ish-Drejtori i Përgjithshëm

███ për shpenzime udhëtim e dieta, të pajustificuara me dokumentacion vërtetues, trajtuar më hollësisht në faqet 71-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2014

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 8,800 lekë nga ███ për shpenzime pritje-përcjellje, të pajustificuara me dokumentacion vërtetues.

Brenda datës 30.10.2014

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 160 euro nga ███ për shpenzime të pajustificuara me dokumentacion vërtetues për fjetje dhe blerje karburanti.

Brenda datës 31.12.2014

6. Nga auditimi u konstatua se: Insig Sh.a. Dega Kosovë, ka paguar penalitetet dhe gjobat e vendosura nga organet kompetente Kosovare, pa nxjerrë më parë përgjegjësitë për këto penalitete dhe gjoba. Nga këto veprime Insig Sh.a. Dega Kosovë, i është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 5,000 euro, vlerë e cila duhet paguar nga znj.███ dhe në vlerën 2,000 euro, vlerë e cila duhet paguar nga Audituesi i Pavarur, ███ Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 2,000 euro, nga ███ për penaltetin e vendosur nga Banka Qendrore e Kosovës, në kundërshtim dhe me nenin 12, të kontratës nr. 2444 prot, datë 16.08.2011 të nënshkruar midis Insig Sh.a. dhe ███ dhe Rregulloren e Bankës Qendrore të Kosovës mbi Sigurimet “Depozitim të aseteve si garanci, mjaftueshmërisë së kapitalit, raportimin financiar, menaxhimin e riskut, investimeve dhe likuiditetin”, neni 31.

Brenda datës 31.12.2014

-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 5,000 euro, nga ███ për penaltetin e vendosur nga Banka Qendrore e Kosovës.

Brenda datës 31.12.2014

7. Nga auditimi u konstatua se: Në 2 raste është likuiduar shoqëria ███ Sh.p.k. ███ për vlerën 139,200 euro, për likuidim të faturës nr. 10-220-2-3, datë 01.10.2010 për vlerën 139,200 euro, për riparimin e zyrave të degës Insig Sh.a. A Kosovë vitit 2010, pa dokumentacion që provohet (vërtetohet) se shpenzimi është kryer, si situacion, procesverbal të marrjes së punës në dorëzim, certifikatë të cilësisë së materialeve të përdorura, etj.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 139,200 euro nga shoqëria ███ Sh.p.k. Podujevë, si shpenzim për riparimin e zyrave të Insig Sh.a. Dega Kosovë, gjatë vitit 2010, shpenzim për të cilin nuk provohet kryerja e tij me dokumentacion justifikues.

Brenda datës 31.12.2014

C. MASA DISIPLINORE

“Instituti e Sigurimeve” (Insig) Sh.a, të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të marrë masat e menjëhershme dhe të nevojshme administrative dhe disiplinore për personelin që aktualisht është në marrëdhënie pune, si dhe të nxjerrë përgjegjësit sipas shkeljeve ligjore dhe përgjegjësiive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, por dhe të Performancës së punës së tyre.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Fatmir Iljazi, Lavdie Fshazi, Alfonc Gabili, Jorida Zhegu, Elira Cukalla më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT